



BASHKIA
TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN DHE JASHTË
DREJTORIA E KOMUNIKIMIT ME QYTETARËT
SEKTORI I OPINIONEVE QYTETARE

Pastrimi i qytetit dhe menaxhimi i mbetjeve urbane

Raport përmbledhës i sondazhit



Korrik 2021

<i>Grafiku 1. Demografia</i>	5
<i>Grafiku 2. Vlerësimi për nivelin e pastërtisë</i>	5
<i>Grafiku 3. Vlerësimi për pastrimin sistematik</i>	6
<i>Grafiku 4. Vlerësimi për pastrimin e plotë</i>	6
<i>Grafiku 5. Vlerësimi për mënyrat dhe mjetet e pastrimit.....</i>	7
<i>Grafiku 6. Vlerësimi për kontrollin ndaj subjekteve ndërtuese/qytetarëve</i>	7
<i>Grafiku 7. Vlerësimi për oraret e pastrimit</i>	8
<i>Grafiku 8. Vlerësimi për grumbullimin dhe largimin e mbetjeve</i>	8
<i>Grafiku 9. Vlerësimi për largimin sistematik të mbetjeve.....</i>	9
<i>Grafiku 10. Vlerësimi për higjenën pranë pikave dhe kontenierëve</i>	9
<i>Grafiku 11. Vlerësimi për shpërndarjen dhe sasinë e kontenierëve në terren</i>	10
<i>Grafiku 12. Vlerësimi për vendndodhjen e pikave të grumbullimit.....</i>	10
<i>Grafiku 13. Vlerësimi për kulturën qytetare</i>	11
<i>Grafiku 14. Gatishmëria për të depozituar mbetjet në fasha të caktuara orare</i>	11
<i>Grafiku 15. Opinioni për ndotjen e kontenierëve nga qytetarët dhe aktivitetet private</i>	12
<i>Grafiku 16. Opinioni nëse indentifikimi i shkelësve dhe aplikimi i penaliteteve do të ndikojë pozitivisht në ruajtjen e pastërtisë</i>	12

Hyrje

Pastrimi i hapësirave publike dhe mirëmenaxhimi i mbetjeve urbane janë dy shërbime shumë të rëndësishme për të gjithë komunitetin por edhe për Tiranën, si një kryeqytet që rritet, zhvillohet, bëhet më tërheqës dhe mirëpret vizitorë e turistë nga rajoni dhe e gjithë bota.

Bashkia Tiranë ka ndërmarrë një sërë nismash në mbështetje të pastrimit dhe higjenizimit të qytetit të tilla si: “Të pastrojmë Tiranën në një ditë”, “Dita pa makina”, larja dhe dezinfektimi i vendeve të ndryshme publike, fushata ndërgjegjësimi për nxënësit në shkolla për diferencimin e mbetjeve si edhe nisma të ndryshme për mbjelljen e pemëve dhe gjelbërimin e qytetit.

Qyteti i Tiranës është i ndarë në 7 zona pastrimi (3 zona lindore, 3 perëndimore dhe Zona e Kuqe në qendër të Tiranës), ku operojnë operatorë privatë me kontrata përkatëse sipërmarrjeje. Në dhjetor të vitit 2016, në “Zonën e Kuqe” ka filluar të operojë edhe shoqëria “Eco Tirana”.

Çdo ditë nga operatorët e shërbimit të pastrimit lahet një sipërfaqe (rrugë) prej rreth 1,978,550 m² dhe fshihet një sipërfaqe (rrugë) prej rreth 2,979,836 m². Kryesisht, mjetet e specializuara që përdorin operatorët e pastrimit janë prodhim i vitit 2010 ndërsa mjetet e shoqërisë “Eco Tirana” janë prodhim i vitit 2016.

Rreth 148 kontenierë në ditë tërhiqen për t’u larë e dezinfektuar dhe rreth 688 tonë mbeturina në ditë depozitohen në Landfillin e Sharrës. Rreth 98.3%, këto janë mbetje urbane (mbetje të prodhuara nga aktiviteti i njeriut) dhe pjesa tjetër inerte e dhera.

Fusha e Sharrës është i vetmi vendgrumbullim për qytetin e Tiranës, ku depozitohen mbetjet urbane të grumbulluara, si nga operatorët privatë të shërbimit që kryejnë pastrimin e qytetit, ashtu edhe nga institucionet apo subjekte të tjera private.

Për të përmirësuar dhe për të arritur menaxhimin e mbetjeve sipas standardeve të kërkuara, me iniciativë të qeverisë Shqiptare dhe me mbështetjen e Bashkisë së Tiranës u bë i mundur realizimi i projektit “Menaxhimi i Mbetjeve Urbane për Qytetin e Tiranës në Sharrë”, me qëllim rehabilitimin e situatës ekzistuese dhe sjelljen e Landfillit në parametrat teknikë të pranueshëm.

Qëllimi dhe objektivat e sondazhit

Qëllimi i këtij sondazhi është të evidentojë opinionin publik lidhur me nivelin e pastërtisë së qytetit dhe perceptimin për cilësinë e shërbimit të grumbullimit dhe largimit të mbetjeve urbane.

Ky sondazh synon të nxjerrë në pah:

1. Opinionin qytetar lidhur me nivelin e pastërtisë së qytetit;
2. Vlerësimin për elementët e shërbimit të pastrimit të hapësirave publike;
3. Opinionin qytetar lidhur me menaxhimin mbetjeve urbane;
4. Vlerësimin për elementët e shërbimit të grumbullimit dhe largimit të mbetjeve;
5. Gatishmërinë e qytetarëve që depozitimin e mbeturinave (hedhjen) në kontenierë dhe largimi i tyre nga Bashkia të bëhet në fasha orare të caktuara, (psh. 2 herë në 24 orë);
6. Mendimin e publikut se kush e rëndon më tepër situatën e kontenierëve publik me mbetje urbane, qytetarët apo aktivitetet (biznese të ndryshme);
7. Opinionin nëse identifikimi i shkelësve dhe aplikimi i penalteteve për qytetarët/subjektet që ndosin territorin do të ishte një hap pozitiv për ruajtjen e higjenës dhe pastërtisë.

REZULTATET KRYESORE TË SONDAZHIT


Nëpërmjet grafikëve, ky raport pasqyron rezultatet kryesore në total të sondazhit, ku secili zë i grafikëve të mëposhtëm shënon të dhënat në total e të gjitha intervistave të kryera, gjatë procesit të vjeljes së opinionit qytetar.

Në këtë sondazh, sipas qëllimit dhe objektivave të tij, u evidentuan çështjet e mëposhtme:


Të dhëna mbi demografinë (rreth **700** qytetarë të anketuar)

Grafiku 1. Demografia


a. Gjinia



b. Grup-mosha (vjeç)




Grafiku 2. Vlerësimi për nivelin e pastërtisë¹




¹ Vlerësimi me pikë nga 1 në 10 (1 = aspak mirë dhe 10 = shumë mirë)


Grafiku 3. Vlerësimi për pastrimin sistematik




Grafiku 4. Vlerësimi për pastrimin e plotë




Grafiku 5. Vlerësimi për mënyrat dhe mjetet e pastrimit




Grafiku 6. Vlerësimi për kontrollin ndaj subjekteve ndërtuese dhe qytetarëve



Grafiku 7. Vlerësimi për oraret e pastrimit




Grafiku 8. Vlerësimi për grumbullimin dhe largimin e mbetjeve²




² Vlerësimi me pikë nga 1 në 10 (1 = aspak mirë dhe 10 = shumë mirë)


Grafiku 9. Vlerësimi për largimin sistematik të mbetjeve




Grafiku 10. Vlerësimi për higjenën pranë pikave dhe kontenerëve




Grafiku 11. Vlerësimi për shpërndarjen dhe sasinë e kontenierëve në terren




Grafiku 12. Vlerësimi për vendndodhjen e pikave të grumbullimit




Grafiku 13. Vlerësimi për kulturën qytetare




Grafiku 14. Gatishmëria për të depozituar mbetjet në fasha të caktuara orare



Grafiku 15. Opinioni për ndotjen e kontenierëve nga qytetarët dhe aktivitetet private



Grafiku 16. Opinioni nëse indentifikimi i shkelësve dhe aplikimi i penaliteteve do të ndikojnë pozitivisht në ruajtjen e pastërtisë



ANEKS 1 – PYETËSORI I SONDAZHIT



BASHKIA
TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN DHE JASHTË
DREJTORIA E KOMUNIKIMIT ME QYTETARËT
SEKTORI I OPINIONEVE QYTETARE

PASTRIMI I QYTETIT DHE GRUMBULLIMI - LARGIMI I MBETJEVE URBANE

Nr. i pyetësorit _____

Tiranë, më ____/____/2021

SEKSIONI I: Të dhëna demografike

Nj.A./Lagje e qytetarit	Gjinia		Grup-mosha (vjeç)			
	F	M	18-35	36-50	51-65	Mbi 65

SEKSIONI II: Pyetje për pastrimin e qytetit

1. Shprehni opinionin tuaj për nivelin e pastërtisë në zonën/njësinë tuaj të banimit.
Vlerësoni me pikë (nga 1 = aspak mirë - 10 = shumë mirë)

Aspak mirë - 1 2 3 4 5 6 7 8 9 10 - Shumë mirë

2. Vlerësoni elementët e shërbimit të pastrimit të hapësirave publike në zonën/njësinë tuaj të banimit:

Nr.	Elementët	Vlerësimi					
		Aspak mirë	Jo mirë	Mesatarisht	Mirë	Shumë mirë	Pa përgjigje
1	Pastrim sistematik (<i>i rregullt dhe i organizuar mirë</i>)						
2	Pastrim i plotë (<i>që përfshin të gjithë zonën</i>)						
3	Mënyrat dhe mjetet e pastrimit						
4	Kontrolli ndaj subjekteve ndërtuese/qytetarëve (<i>pastrimi nga subjektet pranë kantierëve private, largimi individualisht i mbetjeve inerte</i>)						
5	Oraret e pastrimit						

SEKSIONI III: Pyetje për grumbullimin dhe largimin e mbetjeve

3. Shprehni opinionin tuaj për grumbullimin dhe largimin e mbetjeve urbane në zonën/njësinë tuaj të banimit. *Vlerësoni me pikë (nga 1 = aspak mirë - 10 = shumë mirë)*

Aspak mirë - 1 2 3 4 5 6 7 8 9 10 - Shumë mirë

4. Vlerësoni elementët e shërbimit të grumbullimit dhe largimit të mbetjeve urbane në zonën/njësinë tuaj të banimit:

Nr.	Elementët	Vlerësimi					
		Aspak mirë	Jo mirë	Mesatarisht	Mirë	Shumë mirë	Pa përgjigje
1	Largimi sistematik i mbetjeve (<i>i rregullt, i organizuar mirë</i>)						
2	Higjena pranë pikave dhe kontenerët (<i>larje, dezinfektim</i>)						
3	Numri (<i>sasia</i>) i kontenerëve në terren						
4	Vendndodhja e pikave të grumbullimit (<i>kontenerëve</i>)						
5	Kultura qytetare për depozitimin e mbetjeve (<i>paketimi i mbetjeve, hedhja në vendin e duhur</i>)						

5. A do të ishit të gatshëm që depozitimi i mbeturinave (*hedhja*) nga qytetarët në kontenerë dhe largimi i tyre nga Bashkia të bëhet në fasha orare të caktuara, (psh. 2 herë në 24 orë)?

Apak Pak Pjesërisht Dakord Shumë dakord Pa përgjigje

6. Sipas mendimit tuaj, kush e rëndon më tepër situatën e kontenerëve publik me mbetje urbane, qytetarët apo aktivitetet private (*biznese të ndryshme*)?

Aktivitetet Qytetarët Të dyja Pa përgjigje

7. A mendoni se indentifikimi i shkelësve dhe aplikimi i penaliteteve për qytetarët/subjektet që ndosin territorin do të ishte një hap pozitiv për ruajtjen e higjenës dhe pastërtisë?

Po Jo Pjesërisht Pa përgjigje

Ky pyetësor organizohet nga Bashkia e Tiranës dhe ka për qëllim të evidentojë opinionin qytetar lidhur me nivelin e pastërtisë së qytetit dhe perceptimin për shërbimin e grumbullimit - largimit të mbetjeve urbane. Ju sigurojmë që të dhënat tuaja janë për qëllim studimi dhe në përputhje me ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" dhe ligjin nr. 120/2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar" dhe ligjin nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik. Ju falënderojmë për kohën që i kushtuat plotësisht të këtij pyetësori dhe për mendimet që ndatë me ne, me vlerë për përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve të Tiranës.

ANEKS 2 – LITERATURA/ LEGJISLACIONI I PËRDORUR

1. Ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
2. Ligji nr. 120/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar”, miratuar në datën 18.9.2014.
3. Ligji nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.
4. Ligji nr. 8652, datë 31.7.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, i ndryshuar me ligjin nr. 30/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore"”.